

SI TË REGJISTROHENI TE MJEKU I FAMILJES (GP) DHE TË REZERVONI TAKIMIN PËR VAKSINIMIN

NË 12 HAPA TË THJESHTË

SHQIP / ALBANIAN

SI MUND TË MERRNI VAKSINËN KUNDËR COVID-19?



1.


Nëse keni një numër të NHS-së (Shërbimi Shëndetësor Kombëtar), dhe jeni regjistruar në një GP, tashmë mund të rezervoni datën e vaksinimit.



2.

Nuk e mbani mend numrin e NHS-së?

Ai mund të gjendet te recetat tuaja, te letrat e dërguara nga NHS-ja ose në aplikacionin NHS.



3.

Ju gjithashtu mund ta shikoni atë duke futur emrin, datëlindjen dhe kodin tuaj postar në faqen e internetit të NHS-së.

nhs.uk/nhs-services/online-services/find-nhs-number/

SI TË REZERVONI TAKIMIN PËR VAKSINIMIN?



1.

Duke vizituar faqen e internetit të NHS-së, duke telefonuar në linjën telefonike të ndihmës në nr. 119 ose duke kontaktuar GP-në tuaj.

nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/coronavirus-vaccination/book-coronavirus-vaccination/



2.

Ju lutemi mos harroni se vetëm pas 2 dozave të vaksinës do të keni mbrojtje maksimale, prandaj i rezervoni të dy takimet në të njëjtën kohë.



3.

Çfarë ndodh nëse keni rezultuar pozitiv me COVID-19?

Në këtë rast, ju lutemi prisni 4 javë nga data që keni bërë testin, para se të rezervoni një takim.

NUK KENI ENDE NJË NUMËR TË NHS-SË?



1.

Ju mund të pajсени me një të tillë me ndihmën e mjekut tuaj të familjes - i njohur gjithashtu si Mjeku i Përgjithshëm (GP).

Si të gjeni GP-në më

të afërt? Duke përdorur hapësirën e kërkimit në faqen e internetit të NHS-së.

nhs.uk/service-search/find-a-GP



2.

Pasi ta gjeni, regjistrohuni falas pranë një GP-je ose duke telefonuar klinikën tuaj lokale të GP-së ose duke vizituar faqen e tyre të internetit.

nhs.uk/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-surgery/



3.

Ju nuk keni nevojë të paraqisni ndonjë vërtetim të adresës ose statusit ligjor të emigracionit, ID ose një numër të NHS-së për t'u regjistruar. Informacioni juaj nuk do t'u përcillet autoriteteve policore ose të imigracionit.



4.

A keni ende nevojë për t'u regjistruar në GP? Thjesht shtypni ose shkarkoni në pajisjen tuaj këto karta hyrëse të GP-së nga faqja e internetit e Mjekëve të Botës (Doctors of the World) për të shprehur të drejtën tuaj për t'u regjistruar.

doctorsoftheworld.org.uk/gp-access-cards/



5.

Kërkesa juaj e regjistrimit u refuzua?

Gjithmonë mbani mend se të gjithë pacientët në Angli mund të telefonojnë Mjekët e Botës (Doctors of the World) ose NHS-në e Anglisë.

DOTW

0808 1647 686

NHS ENGLAND

0300 311 2233



6.

Pasi të jeni regjistruar me një mjek të përgjithshëm dhe të keni marrë numrin tuaj të NHS-së me postë, atëherë mund të rezervoni takimin tuaj.



In association with



BritishRedCross